



Deklaratë për media

31 Janar 2007

Rishikimi i sektorit për siguri të brendshme në Kosovë i mangët

Dje, pas një viti pune, në mënyrë të qetë u publikuan rezultatet e rishikimit të sektorit për siguri të brendshme në Kosovë, i drejtuar nga KB-ja.¹ Si përgjigje e shpejtë ndaj raportit përfundimtar të rishikimit, Saferworld dhe Forumi i Iniciativës Qytetare (FIQ) shprehin shqetësimet rreth hapsirës së ngushtë të rishikimit dhe këshillimeve të kufizuara me publikun kosovar si dhe dështimit në marrjen parasysh të çështjeve thelbësore të rajonit, të gjitha këto që ndikojnë në zbehjen e rëndësisë së këtij raporti.

“RSSB-ja ka dhënë disa rekomandime të mira përkundër kushteve të vështira, por as procesi i shtrenjtë i rishikimit dhe as publikimi i propozimeve të tij nuk i janë nënshtruar shqyrtimit real të publikut dhe parlamentit. Ndermjet spekulimeve lidhur me propozimet e të Dërguarit Special të KB-së Martti Ahtisaari për statusin përfundimtar, nuk është e qartë se çfarë përfitime do të ketë populli i Kosovës nga ky raport 2 milion dollarësh i RSSB-së” u shpreh Claire Hickson, Kryesuese për komunikim, Saferworld.

Marrja e hapave të sigurt për përmirësimin e sigurisë në Kosovë do të jetë kritike për të ardhmen e Kosovës, pasi të jetë përcaktuar statusi i saj. Rishikimi filloi më këshillimet publike mbi kërcënimet e sigurisë me të cilat përballet Kosova, dhe ishte më ambicioz në këtë drejtim se proceset tjera kudo në botë. Sidoqoftë, përkundër shenjave inkurajuese, procesi u pengua nga një dështim në qasjen e shënimeve të nevojshme dhe perceptimet, kuptimin e çështjeve të rajonit, ose provimin e rezultateve të tij jashtë Komisionit Drejtues.

Megjithatë, nuk ka shumë për të lavdëruar në këtë raport. Ky është shqyrtimi i parë gjithëpërfshirës i normave të sigurisë në Kosovë, duke mbuluar kështu të gjitha fushat, prej policisë tek shërbimet emergjente civile si dhe shëndetësinë dhe ekonominë. Raporti saktësisht përshkruan problemet më shqetësuese të Kosovës si ekonominë të përcjellë nga papunësia e madhe si një nga shkaqet kryesore të pasigurisë. Shumë nga rekomandimet e tij mbi sistemin e sigurisë – si propozimi për krijimin e shërbimeve inteligjente vendore (Shërbimi i Sigurisë i Kosovës), Forcat Mbrojtëse të Kosovës dhe Këshillin Kombëtar të Sigurisë – janë të vështira dhe sfiduese. Rekomandimet tjera si shpërndarja graduale e Trupave Mbrojtëse të Kosovës tashmë janë shumë të vonuara.

Sidoqoftë, rekomandimet dhe konkludimet e raportit janë të pamjaftueshme në disa aspekte. Hulumtimi anon shumë drejt çështjeve ‘të brendshme’, dhe nuk merr parasysh ndërlikimet rajonale të propozimeve të tij, edhe pse çështjet e qeverisjes së sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë luajtën një rol qendror në nxitjen e konfliktit të vitit 1999, dhe ende vazhdojnë të kenë rëndësi të madhe simbolike në dialogët në mes Beogradit dhe Prishtinës.

Qëndrueshmëria dhe efikasiteti afatgjatë i këtyre propozimeve kërkon përfshirjen dhe angazhimin e vetë Kosovarëve. Kultura politike e Kosovës dhe pesimizmi dhe frustrimi aktual në lidhje me papunësinë e madhe, pasigurinë dhe paqartësinë në lidhje me të ardhmen, janë me siguri sfidat më të mëdha për çfarëdo procesi politik në Kosovë. RSSB-ja i shmang në masë të madhe këto çështje duke u përqendruar më shumë në institucionet dhe proceset ligjore formale.

Siguria e re e Kosovës nuk do të përmirësohet derisa Kosovarët tu besojnë atyre që kanë për detyrë të garantojnë sigurinë e tyre. Kështu, implementimi i këtij raporti duhet të përgatitet për problemet e

¹ *Rishikimi i sektorit për siguri të brendshme në Kosovë*, UNDP Kosovë, u komisionua nga ish-Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së (PSSP), Søren Jessen-Petersen.

shkuara duke i kushtuar më shumë vëmendje angazhimit të publikut Kosovar në këtë proces, duke promovuar përgjegjësinë dhe duke sfiduar kulturën politike aktuale.

Saferworld rekomandon që Misioni i KB-së në Kosovë dhe Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse relevante në Kosovë:

- Të sigurojnë që komisioni i ri drejtues të përfaqësoj Kosovarët dhe të jetë përgjegjës ndaj tyre;
- Të drejtojnë një analizë mbi konfliktin e pjesëmarrjes në Kosovë dhe mbarë rajonin për të shqyrtuar shkaqet themelore të konfliktit dhe pasigurisë, dhe të identifikojnë mënyrat për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme negative të reformave pasuese në tensionet ekzistuese të konfliktit. Analiza duhet të përfshij një sferë të gjerë të mbështetësve nga Kosova si dhe mbarë rajoni;
- Të mbajnë këshillime publike në secilën fazë të implementimit të RSSB-së, duke filluar kështu me qasjen në rekomandimet specifike të përfshira në RSSB, dhe zhvillimin e 'letrave të bardha' mbi çështjet specifike për rishikimin e parlamentit dhe publikut;
- T'i kushtojnë më shumë rëndësi qasjes ndër-sektoriale drejt përmirësimit të sigurisë në Kosovë, duke lidhur sigurinë me qeverisjen afatgjatë dhe programet zhvillimore.

Këtë vit, Bashkimi Evropian pritet të nis misionin e tij në Kosovë. Kriteret për këtë mision, i cili është më i madhi i krijuar deri më sot nën Politikën Evropiane mbi Sigurinë dhe Mbrojtjen, janë duke u diskutuar për tani për tani. Është thelbësore që BE-ja të përkrah procesin e një reforme më përfaqësuese dhe reale duke siguruar që Kosovarët të jenë të përfshirë plotësisht në vendimet e ardhme mbi reformën e shërbimeve të sigurisë; dinamikat rajonale janë marrë parasysh në kompozimin dhe implementimin e proceseve të RSS-së; dhe të adresohen shkaqet themelore të tensioneve në Kosovë, si varfëria dhe papunësia.

Shënimi udhëzues (i bashkangjitur) i Saferworld dhe FIQ-it, *Rishikimi i sektorit për siguri të brendshme: një e ardhme e sigurt për Kosovën?* ofron një përgjigje më të detajizuar ndaj dokumentit të Rishikimi i sektorit për siguri të brendshme.

FUND

Forumi i Iniciativës Qytetare (FIQ) dhe **Saferworld** janë implementues të përbashkët të projektit VendiSigurtë, një program puna e të cilit është e përqendruar në përkrahjen e zhvillimit të një sektori efikas të sigurisë, të përgjegjshëm dhe të ndjeshëm ndaj konfliktit në Kosovë.

Saferworld (www.saferworld.org.uk) është një organizatë e pavarur joqeveritare e cila punon në parandalimin e dhunës së armatosur.

FIQ (www.fiq-fci.org) është një organizatë joqeveritare dhe joprofitabile e cila punon në integrimin e qytetarëve të Kosovës në proceset shoqërore dhe të marrjes së vendimeve, nëpërmes programeve të krijuara për t'u përqendruar në vlerat dhe funksionimin e një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Ferdinand Nikolla, FIQ, Prishtinë

Tel: +381 (0)38-248-677; Mob: +377 (0)44-171-845

Jérôme Mellon, Saferworld, Prishtinë

Tel: +381 (0)38-248-677; Mob: +377 (0)44-649-682

Claire Hickson, Saferworld, Londër

Tel: + 44 (0)20-7324-4646; Mob: +44 (0)78-6778-0072

Virginie Giarmana, Saferworld, Bruksel

Tel: +32 (0)2-230-08-28; Mob: +32 (0)475-35-72-76



Shënim udhëzues

31 Janar 2007

Rishikimi i sektorit për siguri të brendshme: një e ardhme e sigurt për Kosovën?

Një shënim udhëzues nga Saferworld (MB) dhe Forumi i Iniciativës Qytetare (Kosovë) mbi Rishikimi i sektorit për siguri të brendshme në Kosovë.

A. Përmbledhje

Ndërtimi i një sektori efektiv dhe të besueshëm të sigurisë është kritik për të ardhmen e Kosovës. Rishikimi i sektorit për siguri të brendshme (RSSB), një hulumtim i gjerë mbi kontekstin aktual të sigurisë në Kosovë, i lëshuar dje në formë të heshtur dhe pa debat, midis spekulimeve rreth propozimeve në lidhje me statusin përfundimtar të Kosovës ka për qëllim ndërtimin e sistem kredibil të sigurisë në Kosovë. Sidoqoftë, procesi i rishikimit dhe përfundimet e tij nuk janë të mjaftueshme për atë çfarë është e nevojshme për të siguruar të ardhmen e Kosovës.

Ky shënim përmbledh procesin e RSSB-së, identifikon zbrazëtitë në analizën e tij, propozon rekomandimet për të çuar punën e RSSB-së përpara, dhe përshkruan sfidat me të cilat do të ballafaqohen ata të cilët kanë për qëllim zhvillimin e një arkitekture të re të sigurisë në vend.

B. Një proces i vështirë

I krijuar në vitin 2005 ndaj sfondit të negociatave mbi statusin përfundimtar nga ish-Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së (PSSP), Soren Jessen-Petersen, RSSB-ja është shqyrtimi i parë gjithëpërfshirës i normave të sigurisë në Kosovë, duke përfshirë kështu të gjitha fushat, prej policisë e deri tek shërbimet emergjente, si dhe shëndetësinë dhe ekonominë.

I aprovuar dhe i përkrahur nga një "Komision Drejtues" i nivelit të lartë, përfshirë përfaqësues nga Misioni i Administrimit të Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara (UNMIK), Bashkimi Evropian, Misioni i OSBE-së në Kosovë, Zyra e Kryeministrit, Shërbimi Policor i Kosovës (ShPK) dhe partitë politike, RSSB-ja ka një rëndësi të madhe dhe është një prodhim i një procesi njëvjeçar i konsultimeve dhe vlerësimeve të udhëhequra nga KB-ja dhe i ndërmarrë në bashkëpunim me Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës. Rekomandimet e tij do të jenë një faktor i rëndësishëm në përcaktimin se si do të formohet struktura qeveritare e Kosovës në të ardhmen, pasi ky vend është duke u afruar secilën herë më shumë drejt zgjidhjes së shumëpritur të statusit politik.

Ky proces është menaxhuar nga një Sekretariat nën Zyrën e Kryeministrit dhe është drejtuar sipas kushteve të referencave strikte dhe metodës së zhvilluar nga Grupi Këshillues i Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar mbi Zhvillimin e Sektorit të Sigurisë (GKZSS). Procesi prej tetë fazave arriti kulminacionin e tij me publikimin e këtij raporti dje, i cili tregon planet specifike për përmirësimin e legjislacionit dhe institucioneve ekzistuese të sigurisë, dhe për krijimin e ri të tyre.

Sidoqoftë, procesi i cili kushtoi mbi 2 milion dollarë është penguar që nga fillimi nga agjendat konkurruese, të cilat janë zhvilluar njëkohësisht me bisedimet diplomatike mbi statusin përfundimtar të Kosovës, si dhe proceset tjera si rishikimi paralel bilateral i sigurisë nga Kombet e Bashkuara.

Pengesat tjera përfshijnë:

▪ **Kufizimet kohore dhe prokurimin**

Për shkak të kufizimeve kohore, dy fazat e para të procesit, përfshirë edhe konsultimet publike mbi 'rishikimin strategjik mbi mjedisin' dhe 'analizat e rreziqeve', janë kontraktuar pa tender të hapur sipas udhëzimeve të Zyrës së PSSP-së. Ky vendim ishte kundër praktikave normale transparente të prokurimit të UNDP-së, dhe ka kufizuar burimet e analizimit.

▪ **Konsultimet e kufizuara publike**

Rishikimi filloi me konsultimet publike mbi kërcënimet e sigurisë me të cilat ballafaqohet Kosova. Këto ishin më ambicioze se në proceset e njëjta tjetërkund, por përsëri ishin të kufizuara. Të njëjtat i kushtuan shumë pak vëmendje çështjeve kyçe si gjinisë dhe armëve të vogla, dhe përderisa i shfrytëzuan mirë mbledhjet publike, këto diskutime të gjëra nuk u kompletuan me një hulumtim të vlefshëm statistikor të popullsisë. Konkludimet dhe rekomandimet e detajizuara të RSBS-së ende duhen testuar nëpërmes konsultimeve të mëtutjeshme publike, pasi që deri më tash janë parë vetëm nga një rreth i mbyllur i Komitetit Drejtues të RSSB-së. Derisa vështrimet e partive politike, institucioneve qeveritare ndërkombëtare dhe vendore janë kritike, ato nuk zëvendësojnë shqyrtimin e publikut të gjerë të përfundimeve dhe rekomandimeve të raportit. Aktualisht nuk ka ndonjë proces të pajtuar për konsultime publike dhe asnjë mekanizëm për ti kthyer rekomandimet e RSSB-së në një politikë publike demokratike të përgjegjshme.

▪ **Dështimi në njohjen e dinamikës së rajonit**

Përkundër një vlerësimi fillestar të sigurisë në rajon, RSSB-ja dështon në njohjen rajonale të ndërlikimeve të sigurisë të implementimit të tij. Çështjet e qeverisjes së sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë kanë luajtur një rol kyç në nxitjen e konfliktit të vitit 1999, dhe ende vazhdojnë të kenë një rëndësi të madhe simbolike në dialogjet politike në mes Beogradit dhe Prishtinës. Deri tani nuk është bërë ndonjë referim ndaj nevojës për menaxhimin e pasojave potenciale negative të implementimit të rekomandimeve të raportit, qoftë të brendshme apo të jashtme. Për shembull, rekomandimet për krijimin e një Force Mbrojtëse ose Shërbimit të Sigurimit mund të shkaktojnë ndërlikime të mëdha në dinamikën rajonale dhe mund të jenë shumë të ndjeshme.

C. Një rezultat jo i përkryer

Raporti saktësisht konkludon se problemi më i madh i sigurisë në Kosovë është ekonomia, duke deklaruar kështu që "papunësia e madhe, mungesa e zhvillimit ekonomik dhe varfëria e madhe kanë krijuar një atmosferë të pasigurisë." Raporti ka zbuluar se edhe çështje tjera sociale si furnizimi me energji elektrike, shëndetësia dhe edukimi gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin se si ndjehen Kosovarët.

Shumë nga rekomandimet e raportit për pastrimin dhe zhvillimin e sistemit të sigurisë në Kosovë në muajt dhe vitet vijuese janë guximtare dhe sfiduese. Propozimet si krijimi i Shërbimit të Sigurimit të Kosovës, Forcave Mbrojtëse të Kosovës dhe Këshillit Kombëtar të Sigurimit janë shumë pozitive, ashtu si thirrjet për përmirësim të përgjithshëm të legjislacionit të mangët nëpërmes një Akti të ri të Sigurisë. Propozimet për ngritjen e vetëdijes publike mbi çështjet e sigurisë dhe fuqizimin e kapacitetit të Kuvendit të Kosovës për mbikëqyrjen e sektorit janë gjithashtu të mirëseardhura.

Si kritike ky raport njihet rrezikun e paraqitur nga shtimi i armëve të vogla dhe të lehta në Kosovë.

Rreziqet e sigurisë në Kosovë:

Në një hulumtues shtëpiak të drejtuar nga Saferworld dhe Forumi i Iniciativës Qytetare në vitin 2006, 87% e të intervistuarve besojnë se armët joligjore paraqesin një rrezik për prosperitetin e ardhshëm të Kosovës. Ky hulumtim gjithashtu ka zbuluar se përafërsisht 300,000 armë zjarri janë në posedimin joligjor të qytetarëve individual dhe grupeve tjera.

Sidoqoftë, përkundër këtyre fuqive, mungesa e përkryerjes në procesin e rishikimit ka çuar drejt pamjaftueshmërisë në raport.

Ky dështon në:

- **Analizimin e qartë të çështjeve, politikave dhe programeve ekzistuese të sigurisë**
Referim i pamjaftueshëm është bërë në këtë raport ndaj politikave dhe programeve të vlefshme për promovimin e sundimit të ligjit në Kosovë, si programet e policisë të bazuara në komunitet, të përkrahura nga OSBE-je dhe DFID-i dhe organizata e institucione tjera. Mësimet nga këto iniciativa është dashur të informojnë rekomandimet e raportit mbi zhvillimin e ardhshëm të vepruesve të mëdhenj të sigurisë si Shërbimin Policor të Kosovës.

Edhe pse raporti njih kërcënimin nga armët e vogla, përsëri dështon që të ofroj një qasje të qartë në problem duke dështuar kështu të krijoj lidhje në mes ndalimit të armëve të vogla dhe reformimit të sektorit të sigurisë.

- **Adresimi i kulturës politike të Kosovës**
Shumë çështje të paqartë si natyra e kulturës politike të Kosovës dhe dobësia e procesit të krijimit të politikave në Kosovë gjithashtu janë neglizhuar. Raporti i RSSB-së tregon shumë pak për atë se si të ndikohet në qëndrimet, sjelljet dhe kulturën politike aktuale, nga të cilat varet ndryshimi real në Kosovë, duke u fokusuar kështu më shumë në ndryshimin e ligjeve dhe institucioneve.

D. Shtyrja përpara e rekomandimeve të raportit të RSSB-së

Pavarësisht nga këto zbrazëti, tash pritet shumë nga implementimi i propozimeve të RSSB-së.

Raporti propozon që të krijohet një Komision Drejtues, i udhëhequr nga Kryeministri i Kosovës dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesve të gjithë Qeverisë dhe donatorëve dhe agjencive të rëndësishme ndërkombëtare, për të caktuar prioritetet e rekomandimeve dhe për të mbikëqyrur implementimin e tyre. Kuptohet, nga një grup kësajsoj i nivelit të lartë kërkohet të ofroj autoritet të mjaftueshëm për punën e vështirë dhe të prekur politikisht të programit. Sidoqoftë, në mënyrë që ky organ të jetë efektiv pyetjet në vazhdim duhen përgjigjur:

- Si do të zhvillohen propozimet e shumta të përfshira në raportin e RSSB-së në politika të detajizuara dhe si do të mund të kenë një shqyrtim efektiv nga Kuvendi i Kosovës dhe publiku i gjerë?
- Si mund të kultivohet qasja “e tërë qeverisë” ndaj kërcënimeve të sigurisë si shëndetësia e dobët, papunësia e madhe dhe gatishmëria për armë të vogla, në mesin e grupeve të ngatërruara të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare?
- Si do të menaxhohen interesat e pashmangshme konkurruese në mes anëtarëve të Komisionit Drejtues, në mënyrë që të ndërmjetësohet në konflikte dhe të sigurohet parësia e përfaqësuesve të zgjedhur ndaj vepruesve tjerë të fuqishëm siç janë donatorët?
- Në çfarë mënyre do të jetë Komisioni Drejtues përgjegjës ndaj publikut për vendimet që i merr në emër të tyre?
- Cilët hapa do të ndërmerren për të monitoruar ndikimet e mundshme, pozitive dhe negative, të implementimit të reformave specifike brenda Kosovës, si një vend i tendosur dhe i prirë për konflikt, dhe brenda rajonit, duke marrë parasysh tensionet e krijuara nga procesi i statusit përfundimtar dhe nga disa reforma të propozuara? Si do të inkorporohen mësimet e mësuara nga ky monitorim në aktivitetet e ardhshme?
- Si do të zgjidhen opinionet e ndryshme brenda Komisionit Drejtues?

Misioni i KB-së në Kosovë dhe Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse duhet të ndërmarrin hapat në vazhdim për përforcimin e implementimit të propozimeve të RSSB-së:

- Të sigurojnë që anëtarësimi nuk përfshinë vetëm përfaqësues nga mbështetësit kryesor të Kosovës por gjithashtu është edhe i përgjegjshëm në mënyrë demokratike ndaj publikut.
- Të drejtojnë një analizë mbi konfliktin e pjesëmarrjes së Kosovës dhe tërë rajonit për të shqyrtuar shkaqet kryesore të konfliktit dhe pasigurisë, dhe për të identifikuar mënyrat për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme negative të reformave të ardhshme në tensionet ekzistuese të konfliktit. Analiza duhet të përfshij një sferë të gjerë të mbështetësve brenda Kosovës dhe nga rajoni i gjerë.
- Të nisin konsultime publike për secilën fazë të implementimit të RSSB-së, prej qasjes në rekomandimet specifike të përfshira në RSSB, e nëpërmes zhvillimit të "letrave të bardha" mbi çështjet specifike për rishikim parlamentar apo publik.
- Të theksoj një qasje ndër-sektoriale ndaj përmirësimit të sigurisë në Kosovë duke lidhur sigurinë me qeverisjen afatgjate dhe programet zhvillimore, si dhe me përpjekjet për ndalimin e armëve të vogla dhe të lehta.

E. Sfidat për arkitekturën e re të sigurisë në Kosovë

Një numër i sfidave më të gjëra duhen adresuar gjithashtu për të siguruar paqe dhe stabilitet afatgjatë në vend.

▪ Mbikëqyrja dhe përgjegjësia

Masa efektive të mbikëqyrjes dhe përgjegjësisë duhen krijuar nëpërmes autoriteteve formale si Kuvendi, dhe nëpërmes mediave, akademive dhe shoqërisë së gjerë civile për publikun e përgjithshëm. Debatet e vërteta në këto arena, më shumë se organizimet e menaxhuara me kujdes për informim të publikut, janë një parakusht për mbikëqyrje dhe përgjegjësi efektive të atyre që do të marrin fuqi të reja si rezultat i implementimit të RSSB-së, përfshirë edhe Zyrën e Kryeministrit (e cila mund të marrë një numër të madh të fuqive), policinë, autoritetet planifikuese dhe shërbimet civile emergjente në nivele komunale.

Për të siguruar një pajtim në mes RSSB-së në nivelin lokal dhe nivelin e mbarë Kosovës, këto debate duhet të përdorin mekanizmat ekzistues, përfshirë edhe të sapoformuarat Këshille Komunale për Siguri në Komunitet, Këshillat Lokal për Sigurinë Publike dhe programet tjera të sigurisë në komunitet dhe të policisë.

▪ Kultura politike e Kosovës

Institucionet e Kosovës, qoftë Shërbimi Policor i Kosovës apo një Shërbim i ri i propozuar i Shërbimeve të Sigurimit në Kosovë, nuk mundën vetë të garantojnë zhvillimin e mëtutjeshëm të sundimit të ligjit në Kosovë, depolitizimin e policisë, inteligjencës dhe shërbimeve gjyqësore, ose edhe mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Edhe pse ligje të reja duhen krijuar dhe duhen ndërtuar kapacitete institucionale, duke caktuar kufijtë e asaj çfarë është dhe çfarë nuk është sjellje e pranueshme për të mandatuarit për ushtrimin e forcës detyruese në emër të shtetit, kultura politike e Kosovës përfundimisht do të përcaktoj se si do të funksionojnë këto institucione. Kjo kulturë do të ketë tendosje të reja dhe të vështira pasi që grupet elite, fraksionet politike dhe elementet kriminale do të provojnë kufijtë e tyre të ri në periudhën e statusit përfundimtar.

▪ Menaxhimi i pritjeve

Përfundimisht, ndonëse ka shumë për të festuar për ndryshimet e propozuara për sigurinë në Kosovë, deklaratimet në këtë fushë duhet të kenë parasysh që Kosovarët janë mësuar me deklaratimet e zbrazëta të progresit si nga politikanët ashtu edhe nga administratorët ndërkombëtar. Konkludimi qendror i raportit të RSSB-së që problemet më të mëdha të sigurisë në Kosovë janë papunësia, varfëria dhe jostabiliteti ekonomik, duhet të japin një paralajmërim të dobishëm. Një qasje ndaj sektorit specifik të sigurisë nuk është e mjaftueshme, dhe duhen krijuar lidhje të duhura me qeverisjen e gjerë dhe programet zhvillimore.

Duhet dërguar një porosi e qartë se zhvillimi i sektorit të sigurisë në Kosovë do të jetë një proces i gjatë, në të cilin rolet e publikut, përfaqësuesve të zgjedhur dhe shoqërisë civile janë po aq të rëndësishme sa të konsulentëve dhe teknokratëve. Një shqyrtim efektiv tash duhet zhvilluar institucione paralele të cilat lejojnë kosovarët e thjeshtë të marrin zotërim më të madh të organeve të cilat ofrojnë sigurinë për ta.

Forumi i Iniciativës Qytetare (FIQ) dhe **Saferworld** janë implementues të përbashkët të projektit VendiSigurtë, një program puna e të cilit është e përqendruar në përkrahjen e zhvillimit të një sektori efikas të sigurisë, të përgjegjshëm dhe të ndjeshëm ndaj konfliktit në Kosovë. Për më shumë informacione vizitoni www.safeplaceproject.org.